



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 49,50 dhe 51 të Ligjit Nr. 2004/15 për Ndërtim, nenit 49, 50 dhe 51 të Ligjit Nr.2004/15 të dt. 27.05.2004 nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-50888/20 dt. 03.03.2020, investitorit “**Sima Com**” **Sh.p.k.**-dega në Kosovë, për lëshimin e Lejes së përdorimit për ndërtesën banesore me afarizëm me etazhitet 2B+P+8, e ndërtuar në Lagjen “Mati 1” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 24.07.2020 lëshon këtë:

V E N D I M

LEJE E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Leja e përdorimit pronarëve Bardhyl Sopi, Tafil e Nazmi Thaqi nga Prishtina me investitorit “**Sima Com**” **Sh.p.k.**-dega në Kosovë me përfaqësues Simon (Preng) Marku, nga Fushë Arre, Pukë, Shqipëri, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-50888/20 dt. 03.03.2020, për përdorimin e ndërtesës banesore me afarizëm, me etazhitet **2B+P+8**, e ndërtuar në kuadër të ngastrës kadastrale nr.-1527-0 si (rezultat i bashkimit të ngastrave 763-1 dhe 763-3), Zona Kadastrale Matičan, blloku urban A10, Lagjja “Mati 1”, sipas Vendimit numër 05 Nr. 351-10262 dt. 26.04.2012 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-10262 dt. 26.04.2012, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të komisionit profesional të pranimit teknik të ndërtesës.

III. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Leje e përdorimit shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Pronarët: Bardhyl Sopi, Tafil e Nazmi Thaqi nga Prishtina me investitorin “**Sima Com**” **Sh.p.k.**-dega në Kosovë me përfaqësues Simon (Preng) Marku, nga Fushë Arre, Pukë, Shqipëri, me kërkesën me 09 Nr. 391/02-50888/20 dt. 03.03.2020, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e Lejes së përdorimit për përdorimin e ndërtesës banesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+8, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Aktvendimi nr. 05 Nr. 351-10262 dt. 26.04.2012 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës afariste me etazhitet 2B+P+8 të pronarëve Bardhyl Sopi, Tafil e Nazmi Thaqi nga Prishtina me investitorit “**Sima Com**” **Sh.p.k.**-dega në Kosovë me përfaqësues Simon (Preng) Marku, nga Fushë Arre, Pukë, Shqipëri, në kuadër të ngastrës kadastrale nr. 00763/1, Zona Kadastrale Prishtinë, në kuadër të bllokut urban A10 , Lagjja “Mati 1”, në rrugën “Ndue Përlleshi” .

Faqe 1 prej 2

- Aktvendimi nr. 05 Nr. 351-10262 dt. 04.04.2012 mbi kompensimin për rregullimin e tokës ndërtimore të pronarëve Bardhyl Sopi, Tafil e Nazmi Thaqi nga Prishtina me investitorit **“Sima Com” Sh.p.k.**-dega në Kosovë me përfaqësues Simon (Preng) Marku.
- Lejen Urbanistike nr. 05 Nr. 350-497/1 dt. 28.12.2011 mbi kushtet tekniko-urbanistike për ndërtimin e objektit investiv në ngastrat kadastrale 763/1 dhe 763/3, Zona Kadastrale Matičan, në rrugën “Ndue Përlleshi”, Lagja “Mati 1”.
- Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të ndërtesës nga komisioni profesional i emëruar nga kjo Drejtoria sipas Vendimit me numër 05-351/04-249149/19 të datës 30.10.2019.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht raportin e komisionit profesional të pranimit teknik të ndërtesës të ndërtimit të ndërtesës dhe të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e investitorit, ka konstatuar se:

Ndërtesa afariste është ndërtuar në pajtim me Vendimet e cekura më lartë dhe dokumentacionit tjetër teknik dhe se i njëjti i përmbush normativat dhe standardet, aplikimi i të cilave është i domosdoshëm me rastin e ndërtimit të ndërtesave të tilla, për çka edhe ka propozuar që Drejtoria e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës t’a lëshoj Certifikatën e Përdorimit.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certifikate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtoria, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-50888/20 DT. 24.07.2020**

Zyrtari:

Berim Osmanaj

U.D. Udhëheqëse e sektorit:

Mimoza Berisha Prestreشي

